

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6584  
E enjte, 14 prill 2022  
çmimi 0.40 €

## Partitë politike pajtohen për reformën zgjedhore



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PRESIDENCA, QEVERIA DHE KUVENDI VAZHDOJNË TË HESHTIN PAS ZHVILLIMEVE TË FUNDIT RRETH DEKLARATËS SË DICK MARTYT

# OSMANI, KURTI DHE KONJUFCA NUK E THONË ASNJË FJALË PËR DEKLARATËN E DICK MARTYT



Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, Vjosa Osmani, Albin Kurti dhe Glauk Konjufca, vazhdojnë të heshtin pas zhvillimeve të fundit për Dick Martyn, i cili ka deklaruar se ka qenë cak i një atentati nga shërbimi sekret serb. Përfaqësues

të partive opozitare, të organizatës së OVLUÇK-së dhe njëhës të proceseve politike kanë thënë se është e pafalshme dhe e pakuptueshme heshtja dhe indiferenca e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës pas kësaj deklarate të Martyt. Sipas

tyre, kur tashmë janë krijuar rrethana të reja për të dëshmuar që Gjykata Speciale është bërë mbi bazën e fakteve të mbledhura nga shërbimet serbe-ruse, krerët e institucioneve të shtetit të Kosovës kanë zgjedhur heshtjen



## QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN QË I HAP RRUGË RITJES SË PAGËS MINIMALE

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



DRONI QË RA NË ZAGREB BARTTE EKSPLOZIV F. 2

DASH: VAZHDON MOSNDËSHKIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË F. 7

TAHIRI: ZRRE-JA TA ZBATOJË VENDIMIN E GJYKATËS PËR PEZULLIMIN E TARIFAVE TË SHITRENJTUARA TË ENERGJISË F. 3

### EKONOMI



KOSOVA NDALON EKSPORTIN E DISA PRODHIMEVE USHQIMORE F. 8

PARALAJMËRON ARRU: DO T'I NDJEKIM PENALISHT KEQPËRDORUESIT E UJIT TË PIJSHËM F. 8

### SPORT



LLAPI DHE DRITA KUALIFIKOHEN NË FINALE TË KUPËS F. 10



# Britania zgjeron sanksionet, synon edhe separatistët e mbështetur nga Rusia

LONDËR, 13 PRILL - Britania e Madhe ka njoftuar për sanksione të reja kundër shumë rusëve, duke përfshirë anëtarët e familjeve të oligarkëve rusë dhe gruan e ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, si dhe liderët e dy rajoneve separatiste në Ukrainë. Gjithsej 206 individë rusë, duke përfshirë 178 "separatistë", gjashtë oligarkë, bashkëpunëtorë dhe punonjës dhe 22 individë të tjerë, u futën në listën e sanksioneve përmes një "procedure urgjente", njoftoi Ministria e Jashtme britanike më 13 prill.

Lista përfshinte Aleksandr Ananchenko dhe Sergei Kozlov, të cilët zyra i përshkroi si "të vetëquajtur kryeministër dhe kryetar i qeverisë së të ashtuquajturve Republika Popullore e Donjeckut dhe Luhanskut" - territore të Ukrainës të njohura nga Rusia si të pavarura dhe të kontrolluara nga separatistët e mbështetur

nga Moska. Sanksionet u zgjeruan, gjithashtu, edhe për biznesmenët rusë Pavel Ezubov, një kushëri i miliardërit rus Oleg Deripaska dhe Nigina Zairova, asistente ekzekutive e bankierit Mikhail Fridman.

Asetet iu ngrinë edhe bashkëshortes së ministrit të Jashtëm rus, Maria Lavrova. "Pas sulmeve të tmerrshme me raketa ndaj civilëve në Ukrainën Lindore, ne sot po i sanksionojmë ata që mbështetin rajonet ilegale të shpëputura dhe janë bashkëpunëtorë në mizoritë kundër popullit ukrainas", tha sekretarja e Jashtme britanike, Liz Truss.

Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Bashkimi Evropian dhe shumë nga aleatët e tyre kanë vendosur sanksione ndaj Moskës prej kur ajo nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Derisa provat e mizorive po



shtohen, sanksionet janë forcuar dhe zgjeruar për ta shtyrë Rusinë drejt tryezës së negociatave.

Ministria e Jashtme britanike tha

në deklaratën e saj se sanksionet e vendosura ndaj Rusisë "kanë pasojë të thella dhe të dëmshme në aftësinë e Putinit për të bërë

luftë", duke shtuar Rusia po shkon drejt recesionit të saj më të thellë që nga rënia e Bashkimit Sovjetik.

## Me sytë kah Rusia, Finlanda dhe Suedia afër anëtarësimit në NATO

HELSINKI, 13 PRILL - Kryeministrja e Finlandës, Sanna Marin, tha se Helsinki është afër marrjes së vendimit që "brenda javësh" të aplikojë për anëtarësim në NATO, në kohën e pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia. "Unë mendoj se do të ndodhë shumë shpejt. Brenda javësh, jo brenda muajve", tha kryeministrja Sanna Marin para gazetarëve të mërkurën më 13 prill në Stokholm.

Homologia suedeze e kryeministres Marin, Magdalena Andersson, paralajmëroi gjithashtu një ndryshim të madh të politikës për kombin e saj si rezultat i pushtimit rus të Ukrainës, duke thënë në konferencë për shtyp se, për shkak të situatës së



sigurisë, Stokholmi po kërkon t'i bashkohet NATO-s.

Anëtarësimi në NATO i njërit prej këtyre shteteve - ose i të dy

shteteve - do të ishte një ndryshim i madh për sigurinë e Evropës dhe një tregues se sa të tronditura janë shumë vende

evropiane nga pushtimi rus.

Si Suedia, ashtu edhe Finlanda, kanë qëndruar neutrale, megjithëse në të kaluarën shpesh kanë bashkëpunuar ose kanë mbajtur stërvitje të përbashkëta me NATO-n. "Arkitektura evropiane e sigurisë ka ndryshuar rrënjësisht si rezultat i pushtimit rus të Ukrainës", tha Marin.

Shumë medie suedeze raportuan më parë se Andersson dhe aleatët e saj politikë do ta kërkonin zyrtarisht anëtarësimin në NATO në qershor, kur aleanca do ta mbajë samitin e saj të ardhshëm. Andersson nuk dha ndonjë koment për këtë.

Në Finlandë - shtet që ndan kufirin prej 1 340 kilometrash

me Rusinë - ligjëvendësit pritet të mbajnë një debat gjatë kësaj jave, pas publikimit të një raporti të qeverisë për anëtarësimin në NATO. Edhe para pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt, opinioni publik në Finlandë po zhvendosej drejt mbështetjes së anëtarësimin në NATO.

Çdo ofertë për anëtarësim duhet të pranohet nga të 30 anëtarët e NATO-s, një proces që mund të marrë katër muaj deri në një vit për t'u përfunduar. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka paralajmëruar se Rusia do të marrë masa për ta "ribalancuar situatën" në rast se Finlanda do t'i bashkohet aleancës.

## Droni që ra në Zagreb bartte eksploziv

Zagreb, 13 prill - Zyra e Prokurorit të Shtetit në Kroaci, ashtu si edhe ekspertët ushtarakë dhe policorë, paraqitën të mërkurën rezultatet e hetimeve në rastin e përplasjes së një droni të kohës sovjetike në pjesën jugore të Zagrebit më 10 mars.

Sipas tyre, hetimet kanë treguar se droni bartte një mjet të improvizuar shpërthyes. Gjithashtu, në ngjyrën e kuqe të yllit në krahun e dronit, ai që e ka lëshuar, ka vënë ngjyrat e flamurit të Ukrainës: të verdhë dhe të kaltër.

Droni i ka nisur manovrat e uljes jo shumë larg Zagrebit, por ekspertët thanë se nuk kanë mundur të konfirmojnë se Zagrebi ka qenë objektivi. Ekspertët supozuan se për ndonjë arsye mund të ketë ndodhur ndonjë gabim gjatë uljes. Jurica Illiq, nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, tha se ky hetim është fokusuar në shkaqet e rrëzimit të dronit, ndërsa hetimi se kush e ka nisur atë dhe nga ka ardhur saktësisht, vazhdon.

Kreu i Sektorit të Policisë Ushtarake Kriminale, brigadieri

Mario Počinok, tha se NATO-ja nuk është informuar ende për rezultatet.

Droni, gati gjashtë tonë i rëndë, i prodhuar në vitet 1980 në Bashkimin e atëhershëm Sovjetik, është rrëzuar më 10 mars në orën 23:01.

Nga hetimet u konstatua se bëhet fjalë për një dron zbulues TU-141, i cili deri në rënien e tij në Kroaci ka kaluar në hapësirat ajrore të dy vendeve anëtare të NATO-s: Rumanisë dhe Hungarisë.

Pas hyrjes në hapësirën ajrore të Kroacisë, droni ka fluturuar



shtatë minuta, me një shpejtësi prej 700 kilometrash në orë dhe në lartësi prej 1 300 metrash përpara se të rrëzohej.

Droni ka rënë në një pyll dhe është përplasur thellë në tokë, kështu që nuk ka pasur dëme serioze.



# Tahiri: ZRRE-ja ta zbatojë vendimin e gjykatës për pezullimin e tarifave të shtrenjtuara të energjisë

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën, ka reaguuar ndaj qëndrimeve të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Themelore për pezullimin e tarifave të shtrenjtuara të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Tahiri ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës e ka marrë me shqetësim jashtëzakonisht të madh vendimin e ZRRE-së për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Themelore. "Vendimi ka hyrë në fuqi në ditën që është publikuar dhe në ditën që e kemi marrë edhe ne, edhe ZRRE. Baza ligjore në të cilën ZRRE thirret që ky vendim nuk ka hyrë në fuqi është e paqëndrueshme. Andaj vendimi i Gjykatës Themelore, Departamenti Administrativ, është jashtëzakonisht i qartë. Ky

vendim ka hyrë në fuqi dhe qytetarët e Kosovës nuk duhet të paguajnë tarifa të energjisë elektrike me rritje për këtë muaj përderisa nuk kemi një vendim tjetër të shkallës së dytë, pra të Apelit", ka theksuar ai. Tahiri i ka bërë thirrje ZRRE-së të mos e apelojë vendimin e gjykatës, sepse ky është në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës, për të cilët rritja e çmimit të energjisë është e papërbalueshme. "Tashmë jemi në një situatë tjetër, ku Republika e Kosovës me prodhimin e energjisë edhe

mund t'i mbulojë nevojat e saj për konsum ditor në raport me energjinë elektrike. Tashmë koha ka ndryshuar drastikisht me periudhën në të cilën është rritur çmimi i energjisë elektrike, pra me janarin, shkurtin, marsin, ku kemi pasur vërtet muaj të ftohtë. Tash në stinën e pranverës konsumi i energjisë elektrike ka rënë jashtëzakonisht shumë", ka thënë Tahiri. Po ashtu, PDK-ja i ka bërë thirrje kryeministrit Kurti dhe presidentes qsmani që të mos insistojnë në rritjen e çmimit të

energjisë elektrike. "Të gjitha statistikat që dalin në raport me rritjen e çmimeve në republikën tonë janë shqetësuese. Ky vendim i Gjykatës Themelore për pezullimin e vendimit të ZRRE-së për ngritjen e çmimit të energjisë deri në 109 për qind është vendim në interes të qytetarëve të Kosovës, një vendim të cilin PDK-ja me juristët e saj e ka argumentuar", ka thënë ai. Tahiri ka theksuar se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, PDK-ja do të angazhohet që të bëjë padi penale për Bordin e ZRRE-së.



## Partitë politike pajtohen për reformën zgjedhore



Prishtinë, 13 prill (ER) - Të mërkurën në Kuvendin e Kosovës është mbajtur një takim konstitutiv për formimin e Komisionit Ad-hoc për reformën zgjedhore. Në këtë takim është nënshkruar deklarata e përbashkët për themelimin e këtij komisioni dhe, po ashtu,

është arritur marrëveshje për formulën e komponimit të komisionit. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se pas një pune intensive dhe takimeve të shumta, partitë politike u pajtuan për formulën e përbashkët të komisionit. "U përmend, gjithashtu, që krahas

këtij komisioni, të themelohet edhe grupi këshillëdhënës i cili do të përbëhet nga përfaqësues të shoqërisë civile të Kosovës që janë marrë me reformën zgjedhore, BE-në, OSBE-në. Mbetemi të përkushtuar të kontribuojmë për një reformë të mirëfilltë zgjedhore në Kosovë", ka thënë Konjufca.

## 23 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 880 testeve, 23 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të mërkurën janë shënuar 18

qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 142. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 509. Në 24 orët e fundit janë dhënë 205 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 823 985 doza të vaksinës. Deri më sot 821 211 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 687 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.







APRESIDENCA, QEVERIA DHE KUVENDI VAZHDOJNË TË HESHTIN PAS ZHVILLIMEVE TË FUNDIT RRETH DEKLARATËS SË DICK MARTYTKUVENDI I KOSOVËS KA DEBATUAR TË MARTËN PËR POLITIKËN E JASHTME

# Osmani, Kurti dhe Konjufca nuk e thonë asnjë fjalë për deklaratën e Dick Martyt

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, Vjosa Osmani, Albin Kurti dhe Glauk Konjufca, vazhdojnë të heshtin pas zhvillimeve të fundit për Dick Martyt, i cili ka deklaruar se ka qenë cak i një atentati nga shërbimi sekret serb. Përfaqësues të partive opozitare, të organizatës së OVLUÇK-së dhe njohës të proceseve politike, kanë thënë se është e pafalshme dhe e pakuptueshme heshtja dhe indiferenca e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës pas kësaj deklarate të Martyt. Sipas tyre, kur tashmë janë krijuar rrethana të reja për të dëshmuar që Gjykata Speciale është bërë mbi bazën e fakteve të mbledhura nga shërbimet serbe-ruse, krerët e institucioneve të shtetit të Kosovës kanë zgjedhur heshtjen

## Faton DËRMAKU

Prishtinë, 13 prill - Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Ganimete Musliu, dhe deputeti, anëtar i këtij komisioni, Bekë Berisha, kanë bashkëbiseduar të mërkurën me drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti, rreth deklaratave të fundit lidhur me rastin e ish-anëtarit të Këshillit të Evropës, Dick Marty. Pas takimit për media, ka folur deputetja Ganimete Musliu, e cila

ka thënë se kjo heshtje e presidentes Vjosa Osmani dhe kryeministrit Albin Kurti ndaj deklaratës së Martyt, tregon joseriozitetin e institucioneve shtetërore për ta zbardhur të vërtetën mbi luftën e drejtë të UÇK-së. "Në bazë të kompetencave që më lejon rregullorja e Kuvendit kam thirrur në takim urgjent drejtorin e AKI-së për të na njoftuar rreth njohurive që mund të ketë ky institucion në lidhje me rastin. E falënderoj z. Ajeti për prezencën e tij. Edhe pse ishin të njoftuar të gjithë anëtarët e komisionit parlamentar, kjo

mbledhje u bojkotua nga Lëvizja Vetëvendosje. Heshtja e presidentes Vjosa Osmani, kryeministrit Albin Kurti dhe bojkoti nga deputetët e LV-së, për t'ia pamundësuar raportimin në komision drejtorit të AKI-së, lë për të dyshuar se kjo qasje është e sinkronizuar. Kjo sjellje lë shije të keqe dhe tregon joseriozitetin e institucioneve shtetërore për ta zbardhur të vërtetën mbi luftën e drejtë të UÇK-së", ka thënë deputetja Musliu. Ajo ka thënë se sot kur në tërë botën po raportohet lidhur me kërcënimet e shërbimeve serbe ndaj Martyt dhe janë krijuar rrethana të reja për të dëshmuar që Gjykata Speciale është bërë mbi bazën e fakteve të mbledhura nga shërbimet serbe e ruse, në vend se të aktivizohet i tërë shteti e ta kryejë punën e vet, shteti ynë ka zgjedhur të heshtë", është shprehur deputetja Musliu. Deputeti i AAK-së, Bekë Berisha, ka thënë se kemi ardhur në një situatë ku Dick Marty ka hequr dorë nga agjenda ruse-serbe dhe nga akuzat kundër UÇK-së, derisa Albin Kurti dhe LV-ja janë duke e mbajtur ende frontin. "Sot LV-ja e bojkotoi raportimin e shefit të AKI-së për këtë skandal ndërkombëtar, për të

cilin qeveria jonë nuk e thotë asnjë fjalë. Albin Kurti tashmë është pozicionuar kundër UÇK-së dhe Amerikës edhe si kryeministër", ka thënë deputeti Berisha. Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka kërkuar të mërkurën nga Gjykata Speciale që ish-senatori Dick Marty të ftohet si dëshmitar pas deklaratimeve të këtij të fundit se ka qenë cak i një atentati nga shërbimi sekret serb. Ushtruesi i detyrës kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, u ka bërë thirrje autoriteteve të shtetit të Kosovës që të ngrënë në instanca ndërkombëtare deklaratimet e ish-raportuesit në Këshillin e Evropës, Dick Marty, se është kërcënuar me vrasje nga shërbimi serb e që synonte t'i fajësonte shqiptarët. "Nuk është hera e parë që Serbia mundohet t'ua veshë shqiptarëve të gjitha të këqijat që i kanë bërë. Ka pasur shumë ngjarje të tjera si rasti 'Panda' që i ka vrarë vetë fëmijët dhe është munduar t'ua veshë pjesëtarëve të UÇK-së apo rasti i Martinoviqit me shishen e famshme që gjoja shqiptarët e paskan dhunuar. Serbia si shtet e pushtues vazhdimisht ka bërë këso inskenime e ngjarje, pra është munduar t'ua veshë shqiptarëve.

Shteti i Kosovës sot nuk do të duhej të heshte. Qoftë Qeveria, Kuvendi apo Presidenca. Sidomos tash kur gjoja po kërcënohet nga shërbimi serb, e ta ngrehë si çështje në takime me organizmat ndërkombëtarë, sepse është luftë kundër Kosovës dhe UÇK-së", ka thënë Klinaku. Ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka alarmuar institucionet e Kosovës për Gjykatën Speciale dhe deklaratat e Dick Martyt për kërcënime nga Serbia. Sipas tij, për herë të parë pas shpërbërjes së Jugosllavisë, një shtet - Kosova, në krye me Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, del kundër mbrojtjes së luftëtarëve të tyre në një proces gjyqësor. "Për herë të parë pas shpërbërjes së Jugosllavisë, një shtet - Kosova, në krye me Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, del kundër mbrojtjes së luftëtarëve të tyre në një proces gjyqësor. Serbia e kishte mbështetur madje edhe Millosheviqin, që kishte kryer gjenocid në Kosovë dhe në Bosnje. Derisa, këta frikësohen nga pafajësia e krerëve të UÇK-së. Është dita e katërt dhe asnjë fjalë për deklaratën e Dick Martyt. Lufta çlirimtare në fund do të ngadhënjë kundër akuzave të



# Qeveria miraton projektligjin që i hap rrugë rritjes së pagës minimale

PRISHTINË, 13 PRILL - Pas njëmbëdhjetë vjetësh Qeveria e Kosovës ka miratur projektligjin që i hap rrugë rritjes së pagës minimale. Sipas këtij projektligji, paga minimale do të rritet në 264 euro bruto, apo 250 euro neto. Nga kjo rritje do të përfitojnë rreth 300 mijë punëtorë, ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë, të mbajtur më 13 prill. Në mbledhje është vendosur që paga deri në 250 euro të lirohet nga tatimi. Rritje të pagës minimale vazhdimisht kanë kërkuar Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit. Kërkesa e tyre është rritur muajt e fundit, pas rritjes së vazhdueshme të inflacionit në

Kosovë. Inflacioni, në anën tjetër, në muajin mars ka arritur në 10 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pas miratimit në qeveri, projektligji për pagën minimale duhet të miratohet edhe në Kuvendin e Kosovës. Sipas rregullores së Kuvendit, shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë punë dhe as më vonë se katër javë punë, nga dita e shpërndarjes së tij. Pas kësaj ligji u kthehet në shqyrtim komisioneve të ndryshme dhe amendamentet mund të parashtrihen në afat prej dy javësh. Pastaj, komisioni funksional ia paraqet Kuvendit raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, ose pesë ditë



pune para shqyrtimit të dytë në mbledhje plenare. Vlera e pagës minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar nga viti 2011.

Shuma e pagës minimale në Kosovë është më e ulëta në Evropë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave, Eurostat. Ajo është

e ndarë në dy kategori: 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit mbi 35 vjeç.

## Reformat në drejtësi drejt përmbushjes së zotimeve të përbashkëta

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e shoqëruar nga zëvendësministri Blerim Sallahu, së bashku me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, kryetarin e Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka marrë pjesë në punëtorinë e cila ka për qëllim hartimin e reformës në tri fusha të rëndësishme për sundimin e ligjit në vend, përfshirë draftimin e Koncept-dokumentit për Kodin e Procedurës Civile, Koncept-dokumentit për Drejtësinë Administrative dhe të Punës si dhe Reformimi i Gjykatës Supreme, përkatësisht Dhomës së Posaçme. Në fjalën e saj hyrëse, ministrja Haxhiu ka vlerësuar angazhimin e përbashkët të institucioneve të



drejtësisë me ç'rast ka theksuar zotimin i cili është bërë me qëllim për ta ngritur nivelin e bashkëpunimit dhe kontributit në mes të këtyre institucioneve për të avancuar me reformat në fushat e caktuara të sundimit të

ligjit, ndër të tjera, në atë civile dhe administrative. Në këtë drejtim Haxhiu ka thënë se Ministria e Drejtësisë vlerëson bashkëpunimin e ofruar nga Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme. "Marrë parasysh

obligimet që kemi ndërmarrë si institucione, jam e bindur se grupet punues të cilat janë themeluar për çështjet e caktuara do ta kryejnë punën me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm", ka thënë ajo. Ministria ka shtuar se mbeten të përkushtuar që duke i prioritetizuar problemet, të angazhohen për zgjidhjen e plotë të tyre, duke bërë që bashkë me rezultatet e institucioneve, të rritet edhe besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, ka theksuar rëndësinë e këtij takimi të përbashkët, rezultatet e të cilit, tha ai, do të jenë të dukshme në çështjet që janë identifikuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Gjykatën Supreme. Zogaj ka thënë se është i njohur

fakti se drejtësia procedurale e shihet të nevojshme që të avancohen disa pjesë të këtij legjislacioni, përfshirë pjesën e komunikimit elektronik, pjesën e seancave, atë të barazisë në procedura gjyqësore, efikasitetit, si dhe nevojën e eliminimit të disa problematikave të cilat janë evituar gjatë praktikës gjyqësore. Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, e ka vlerësuar si moment të rëndësishëm bashkëpunimin ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse për çështjet të cilat janë marrë vesh me zotimin e arritur. Në këtë takim është theksuar se Ministria e Drejtësisë mbetet e përkushtuar për të avancuar me tej këtë bashkëpunim të mirë që ka arritur me institucionet e drejtësisë dhe partnerët strategjikë si pjesë e rëndësishme e reformave në drejtësi.

Dick Martyt, kundër propagandës ruse-serbe, kundër Prokurorisë dhe, fatkeqësisht edhe kundër symbylljes së Kurtit, Osmanit dhe Gërvallës", ka thënë Behrami. Edhe analisti politik Ilir Ibrahim i ka thënë se është e pafalshme dhe e pakuptueshme heshtja dhe indiferenca e qeverisë pas zhvillimeve rreth Dick Marty dhe rrezikimit të tij nga shërbimet sekrete serbe. "Pothuajse po aq e pafalshme është edhe heshtja e partive opozitare, LDK-së, PDK-së dhe AAK-së. Për shtetin kanë përgjegjësi qeveria dhe opozita. Koha për kalkulime nuk është tash. Lufta politike, kur interesat e vendit janë në rrezik, i kontribuojnë mu atyre përpjekjeve kundër interesave shtetërore", ka thënë Ibrahim.

## Ministria e Jashtme ta themelojë grupin punues kundër pretendimeve të Dick Martyt

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, një ditë më parë në Kuvendin e Kosovës ka kërkuar nga ministrja e jashtme, Donika Gërvalla, të bëjë diçka në mënyrë që si shtet t'i kthejnë si të pabaza pretendimet e Dick Martyt. "Ne e kemi një situatë shumë të rëndë, e cila nuk po merr vëmendje. Ka të bëjë me çështjen e deklarimit të Dick Martyt. Të nderuar deputetë

dhe qeveri, Dick Marty ia ka qitë faqen e zezë këtij vendi. Prej vitit 2013, që unë udhëtoj jashtë, njerëzit na kanë këqyrë si me qenë kanibalë, që presim veshkë, që bartim organe prej një vendi në një vend. Për këtë çështje, për këtë raport, burrat që i kanë bërë nder këtij vendi, presidenti, dy kryeparlamentarët, deputeti Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Nasim Haradinaj, pra të gjithë janë në Hagë. Nuk po përzihem nga parlamenti, sepse

vetë e keni çuar dorën e ia pafshi qyken e hajrit, por jam duke thënë që politika e jashtme duhet ta ketë një strategji se si t'ia kthejmë Dick Martyt", ka thënë Tahiri, duke shtuar se Dick Marty është deklaruar se i është kërcënuar jeta nga Serbia. "Sot është deklarata e qeverisë zvicerane që thotë se kanë dashur ta kërcënojnë. Shteti i Kosovës, nëse s'mund t'u ndihmojë, ia ka borxh historisë, vendit, që ta bëjë një dokument,

sepse e kemi hëngër për dhjetë vjet tregimin e tij, dhe tërë bota na ka sharë e na ka sulmuar. Ejani t'ia kthejmë e t'u themi që jeni ju ata (Shërbimi Sekret Serb) që ia keni dhënë informatën e rrejshme, e mbi të ai ka bërë raport të rrejshëm. Kërkesa ime për ju ministre është që të bëni ndonjë ngjarje në politikë të jashtme, ndonjë samit dhe ta nisni iniciativën për t'ia kthyer Dick Martyt", ka deklaruar Tahiri.



## Mbyllen përkohësisht gjashtë biznese afariste në Mitrovicë

MITROVICË, 13 PRILL (ER) - Drejtoria e Inspeksionit e komunës së Mitrovicës ka kryer kontrolle inspektuese sipas detyrës zyrtare në disa subjekte afariste, kryesisht në argjendaritë e qytetit të Mitrovicës. "Qëllimi i këtyre inspeksioneve ka të bëjë me respektimin e orarit të punës sipas Rregullores Komunale nr.

03/2014, me ç'rast janë mbyllur përkohësisht gjashtë argjendari si pasojë e mosrespektimit të orarit të punës. Me këtë rast inspektorët komunalë kanë marrë masa konform ligjeve në fuqi dhe përkohësisht kanë ndaluar zhvillimin e veprimtarive të këtyre subjekteve", ka njoftuar komuna e Mitrovicës.



## Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Kadastrale arrijnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se me Agjencinë Kadastrale të Kosovës kanë

nënshkruar memorandum bashkëpunimi për plotësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të adresave në territorin e kryeqytetit. Ai ka treguar se në

këtë takim kanë diskutuar edhe për reformat dhe projektligjin e kadastrës me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve.



## Kryetari i Rahovecit përkujton dëshmorët Dalip Behra dhe Bekim Gashi

RAHOVEC, 13 PRILL (ER) - Njëzet e tre vjet më parë, në një betejë të përgjakshme me armikun, ranë dëshmorë Dalip Behra dhe Bekim Gashi nga Krusha e Madhe. "Dy luftëtarët e dëshmuar në beteja të shumta të luftës sonë

çlirimtare u përjetësuan me sakrificën e tyre sublime për atdhe dhe liri. Sot, me bashkëpunëtorë, bashkëluftëtarë e familjarë, nderuam kujtimin e emrit dhe veprën e tyre madhështore të 13 prillit 1999, te vendi i rënies, i njohur si Rrezet e

Krushës. Dalipi e Bekimi sot dukeshin më të gjallë se kurrë, më krenarë se kurrë", ka thënë kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi. Ai ka thënë se falë sakrificës së heronjve e dëshmorëve të kombit sot gëzojmë lirinë dhe shtetin e pavarur.

## Përurohet Ambulanca e Mjekësisë Familjare në Dumnicë të Podujevës

PODUJEVË, 13 PRILL (ER) - Në fshatin Dumnicë është bërë përurimi i Ambulantes së Mjekësisë Familjare. Në ceremoninë solemne të hapjes së ambulantes së re ishte i pranishëm kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Driton Veliu, stafin

menaxherial të QKMF-së dhe banorët e këtij fshati. Kryetari Bulliqi ka uruar banorët e kësaj zone për funksionalizimin e ambulantes duke u premtuar që do të angazhohet në vazhdimësi për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve shëndetësore për gjithë qytetarët dhe personelin mjekësorë.



## Në 24 orët e fundit, 24 lindje në QKUK

Prishtinë, 13 prill (ER) - Njëzet e katër lindje, shtatë prej tyre me operacion, janë kryer në Klinikën e

Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në 24 orët e fundit. Gjashtëmbëdhjetë foshnja i

përkasin gjinisë femërore dhe dhjetë foshnja të tjera i takojnë gjinisë mashkullore. Një nënë ka

lindur binjakë derisa, sipas raportit të punës, dhjetë gra shtatzëna janë bërë nëna për herë të parë.





# DASH: Vazhdon mosndëshkimi i korrupsionit në Kosovë

PRISHTINË, 13 PRILL - Në raportin për të drejtat e njeriut në botë në vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit tha se në Kosovë çështjet e rëndësishme të këtyre të drejtave përfshinin raporte të besueshme për: kufizime serioze në lirinë e shprehjes dhe medias, duke përfshirë dhunën ose kërcënimet për dhunë gazetare; korrupsionin serioz qeveritar dhe mosndëshkimin dhe krimet që përfshijnë dhunën ose kërcënimet me dhunë ndaj pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të marginalizuara.

Qeveria, thuhet në raport, ndërmori hapa për t'i identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zyrtarët që kryen shkelje të të drejtave të njeriut, por nganjëherë nuk kishte qëndrueshmëri në veprime. Shumë njerëz në qeveri, opozitë, shoqëri civile dhe media raportuan raste të zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion ose duke vepruar pa u ndëshkuar. Qeveria ndonjëherë pezulloi, largoi shkelësit nga detyra ose transferoi të akuzuarit, dhe sektori i drejtësisë ndonjëherë ndërmori hapa për të ndjekur penalisht dhe ndëshkuar ata zyrtarë që kryen shkelje dhe krimet. Megjithatë, shumë zyrtarë të korruptuar vazhduan të mbajnë pozita në sektorin publik. Në raport përmendet puna e Gjykatës Speciale të Kosovës për krime lufte me seli në Hagë dhe veprimet për ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës nga gjykatat në Kosovë. Deri në shtator Prokuroria e Specializuar e Kosovës (PSRK) kishte nën hetim zyrtar 12 raste të krimeve të luftës. Gjatë vitit PSRK-ja ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve. Një rast i profilit të lartë të krimeve të luftës, i njohur si "Drenica I", u dërgua për rigjykim në vitin 2017, por u vonua disa herë. Deri në dhjetor nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore. Raporti vë re se në korrik një gjykatë në Prishtinë dënoi ish-policin serb Zoran Vukotiq me tre vjet e gjysmë heqje lirie për përdhunimin e një gruaje shqiptare shtatzënë gjatë kohës së luftës dhe për pjesëmarrje në dëbimet e civilëve shqiptarë të Kosovës nga qyteti i Vushtrrisë në vitin 1999. Që nga viti 2019 Vukotiqi ishte në vuajtje të dënimit prej gjashtë vjet e gjysmë për krimet e luftës të ndalimit dhe torturimit të paligjshëm të të burgosurve shqiptarë nga Kosova në rajonin e Mitrovicës. Dënimi shtesë shënoi herën e parë që një gjykatë e Kosovës dënon një të pandehur për përdhunim gjatë luftës.

Raporti përfshin edhe dënimin në muajin mars të serbit nga Kosova, Zllatan Kërstiq dhe shqiptarit Destan Shabani, të dy ish-oficerë të policisë serbe, me përkatësi të 14 vjet e gjysmë dhe shtatë vjet burgim, për krime lufte kundër civilëve shqiptarë në vitin 1999. Ndërsa në shkurt, një gjykatë në Prishtinë dënoi serbin e Kosovës, Zoran Gjakij, me 12

vjet heqje lirie për krime lufte kundër shqiptarëve të Kosovës të kryera ndërmjet marsit dhe prillit 1999 në rajonin e Pejës.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur tha në muajin shtator se 1 632 veta ende llogariten si të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998-99 dhe dhunës politike që pasoi. Sipas ligjit, baza e të dhënave të personave të zhdukur të qeverisë nuk përfshin përkatësinë etnike të personave të zhdukur, përveç nëse raportohet vullnetarisht nga familja e tyre. Komisioni la të kuptohet se rreth 70 për qind janë shqiptarë, ndërsa 30 për qind ishin serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë, goranë, malazezë dhe të tjerë.

## Keqtrajtimi i të burgosurve

Raporti përfshin edhe ankesat për keqtrajtimin e të burgosurve dhe përdorimin e dhunës nga pjesëtarët e organeve të rendit. Qeveria ndonjëherë hetonte shkeljet, megjithëse mekanizmat për ta bërë këtë nuk ishin gjithmonë efektivë ose ishin subjekt i ndërhyrjeve politike, gjatë periudhës që përfshin raportin. Forcat e sigurisë, thuhet në raport, nuk siguruan respektimin e urdhrave të gjykatës kur zyrtarët lokalë nuk i zbatuan ato. Edhe pse disa oficerë policie u arrestuan me akuza për korrupsion gjatë vitit, mosndëshkimi mbeti një problem. Raporti përfshin të dhënat e Inspektoratit Policor të Kosovës i cili deri në nëntor kishte pranuar 1 862 ankesa, 617 prej të cilave janë dërguar për hetim penal. Ankesat ishin kryesisht për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, keqpërdorim të detyrës zyrtare, lëndim trupor, kanosje dhe dhunë në familje. Inspektorati raportoi se 158 policë ishin nën hetim, 78 ishin pezulluar dhe 31 ishin arrestuar.

## Pavarësia gjyqësore

Raporti thekson se, sipas Komisionit Evropian, organizatave joqeveritare dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, administrimi i drejtësisë ishte i ngadaltë dhe i mungonin mjetet për të siguruar llogaridhënien e zyrtarëve gjyqësorë. Strukturat gjyqësore iu nënshtruan ndërhyrjeve politike, emërimeve të kontestuar dhe mandateve të paqarta. Mes të tjerash, raporti thekson se autoritetet ndonjëherë nuk arritën t'i zbatonin urdhrat e gjykatës, përfshirë edhe të Gjykatës Kushtetuese. Disa përfaqësues të serbëve të Kosovës pohuan se institucionet qeveritare dështuan në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në favor të serbëve të Kosovës, veçanërisht në mosmarrëveshjet lidhur me pronën. Autoritetet qendrore dhe lokale në Deçan vazhduan ta refuzojnë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016



që konfirmon pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe mbi më shumë se 24 hektarë tokë në afërsi të Manastirit të Deçanit. Në shtator, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje refuzimin e vazhdueshëm të qeverisë për ta zbatuar vendimin e gjykatës dhe ia referoi çështjen prokurorit të shtetit. Deri në dhjetor prokurori nuk kishte filluar procedimin penal. Asnjë nga zyrtarët që nuk kanë zbatuar urdhrin e gjykatës nuk janë sanksionuar, thuhet në raport.

## Korrupsioni dhe transparenca qeveritare

Raporti thekson se zyrtarët ndonjëherë përfshiheshin në praktika korruptive pa u ndëshkuar dhe se mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit kontribuuan në këtë problem. Çështjet e korrupsionit në mënyrë rutinore u nënshtrueshin apelimeve të

përsëritura dhe sistemi gjyqësor shpesh lejonte parashkrimin apo skadimin e afatit për të gjykuar çështjet. Në raport thuhet se Prokuroria Speciale ngriti nëntë aktakuza lidhur me korrupsionin deri në dhjetor të vitit 2021, por një pjesë e vogël e rasteve të korrupsionit që u hetuan dhe për të cilat u ngritën akuza, përfunduan me dënime. Organizatat joqeveritare vendase dhe organizatat ndërkombëtare, thuhet në raport, pretenduan për dështime të shumta nga sistemi gjyqësor për ta ndjekur penalisht korrupsionin, duke vënë në dukje se shumë pak raste të ngritura kundër zyrtarëve të lartë rezultuan me dënime dhe dënimi i zyrtarëve të nivelit të lartë për korrupsion ishte shpesh i butë.

## Përdhunimet dhe dhuna në familje

Raporti citon Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimi e Ligjit (EULEX), sipas të cilit

gjykatat shpesh zbatonin dënime më të lehta se minimumi ligjor në rastet e përdhunimit dhe se organet e sundimit të ligjit rrallë ndërmerrnin hapa për të mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët.

Zyra e Prokurorisë për Ndihmë ndaj Viktimave raportoi një rritje të dhunës familjare nga 1 145 raste të raportuara në vitin 2020 në 1 374 raste nga janarit deri në gusht të vitit 2021. Dhuna seksuale dhe përdhunimi që ndodhin brenda ose jashtë familjes, rrallë u raportuan nga viktimat, shpesh për shkak të frikës nga stigma shoqërore ose mungesa e besimit tek autoritetet.

Raporti iu referohet organizatave për të drejtat e grave, sipas të cilave, ngacmimi seksual ishte i zakonshëm në vendet e punës si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke përfshirë edhe institucionet publike të arsimit të lartë.

(Zëri i Amerikës)

## Raporti i DASH-it: Gazetarët në Kosovë hasën në vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka shprehur shqetësimin lidhur me gjetjet kryesore të raportit të Departamentit të Shtetit të ShBA-së për Kosovë.

Në raportin e publikuar këtë javë thuhet se pavarësisht që në përgjithësi u respektua liria e shprehjes, sërish pati tentime për frikësim të përfaqësuesve të medieve nga politikanë, persona publikë, biznese dhe grupe fetare.

Raporti evidenton se problemet e financimit gjithashtu dëmtojnë pavarësinë e medieve, si dhe pati vështirësi për marrjen e informatave nga qeveria dhe institucionet publike. "Gazetarët

hasën në vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike, pavarësisht nga ligjet që ofrojnë qasje në dokumente publike", thuhet në raport.

Sipas raportit, mediet e pavarura ishin aktive dhe shprehën një shumëllojshmëri pikëpamjesh, përgjithësisht pa kufizime. Megjithatë, disa zyrtarë qeveritarë, parti politike, biznese të lidhura me qeverinë, grupe fetare dhe individë të pakënaqur u bënë trysni pronarëve të medieve, redaktorëve dhe gazetarëve që të mos publikonin rrëfime ose materiale të caktuara. Departamenti Amerikan i Shtetit citon raportet e Asociacionit të

Gazetarëve të Kosovës për sulmin fizik ndaj Visar Duriqit, intervistimin nga Prokuroria të Parim Ollurit për raportimin për vaksinat, si dhe kërcënimin e deputetit të Vetëvendosjes, Haki Abazi ndaj portalit "Albanian Post", si tri prej incidenteve më të rënda në vitin 2021. AGK-ja vlerëson se gjetjet e raportit duhet të jenë alarm për institucionet e vendit që duhet të angazhohen për krijimin e një ambienti më të mirë e të sigurt të të bërit gazetar. AGK-ja, gjithashtu, fton pronarët e medieve që të lejojnë që gazetarët të raportojnë pa u censuruar e frikësuar se do ta humbasin vendin e punës.



## Kosova ndalon eksportin e disa produkteve ushqimore



**PRISHTINË, 13 PRILL** - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që ta ndalojë përkohësisht eksportin e disa produkteve ushqimore në vende të rajonit dhe më gjerë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën në një mbledhje të qeverisë se qëllimi i këtij vendimi është që të sigurohet

furnizimi i qytetarëve me produkte si gruri, misri, mielli, vaji ushqimor, kripa e kuzhinës dhe sheqeri.

“Invazioni rus dhe agresioni ushtarak në Ukrainë ka ndikuar në zinxhirin e furnizimit me produkte agro-ushqimore në Evropë”, ka thënë Kurti.

Kosova nuk ka nivel të lartë të eksportit.

Eksporti i mallrave “Made in Kosova” në muajin shkurt, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, kishte vlerën 65.2 milionë eurove, ndërsa importi vlerën e 414.7 milionë eurove. Por, ministrja e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës, Rozeta Hajdari, ka thënë se “eksporti i mallrave, sado i vogël të jetë, mund ta rrezikojë furnizimin e popullatës në të ardhmen”.

Edhe Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë vënë ndalesa në eksportin e mallrave të caktuara

ushqimore.

Por disa ditë pas vendimit, autoritetet serbe kanë paralajmëruar se do të rinisin eksportet e grurit për vendet e nismës “Ballkani i Hapur” që, përveç Serbisë, përfshin edhe Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

## Paralajmëron ARRU: Do t’i ndjekim penalisht keqpërdoruesit e ujit të pijshëm



**PRISHTINË, 13 PRILL (ER)** - Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) ka paralajmëruar se do të ndërmarrë veprime ligjore ndaj atyre që e shfrytëzojnë ujin nga rrjeti publik pa lejen e ofruesit të shërbimeve të ujit.

Në komunikatën për medie thuhet se si rezultat i keqpërdorimeve të ujit dhe kyçjeve të paautorizuara në rrjetin publik, humbjet e ujit janë shumë të larta, që në nivel vendi në vitin 2021 janë llogaritur të jenë 55 %. “ARRU ka kërkuar nga të gjithë

ofruesit e shërbimeve të ujit që t’i shtojnë përpjekjet për identifikimin dhe përdorimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kundër të gjithë atyre që e shfrytëzojnë ujin nga rrjeti publik pa lejen e ofruesit të shërbimeve të ujit. Shfrytëzimi i ujit në mënyrë të paautorizuar paraqet vepër penale dhe si veprim është i dënueshëm sipas Kodit Penal të Kosovës”, thuhet në komunikatën për medie të ARRU-së.

Mes të tjerash, thuhet se keqpërdorimi i ujit do të paraqesë

vështirësi të theksuara për furnizim të rregullt me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët, në veçanti gjatë sezonit të verës. “ARRU, po ashtu, ka inkurajuar ofruesit e shërbimeve të ujit që t’i rritin përpjekjet për t’i nënshkruar kontratat e shërbimit (për ujë dhe ujëra të ndotur) me të gjithë konsumatorët, si mekanizëm për t’i zvogëluar keqpërdorimet e ujit dhe rastet e kyçjeve të paautorizuara në rrjetin publik”, është theksuar në këtë komunikatë.

## Në javët e ardhshme inaugurohet Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në Pejë

**PRISHTINË, 13 PRILL (ER)** - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Liburn Aliu, ka njoftuar se ka vizituar Impiantin për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) në Pejë. Sipas Aliut, ITUN është paraparë për 60 mijë banorë, me mundësi të zgjerimit deri në 98 mijë banorë duke shtuar se pritet të inaugurohet në javët në vijim. “Në shoqërim të kryetarit të

komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe zyrtarëve të KRU Hidrodrini, vizitova Impiantin për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) në Pejë, investim i përbashkët në vlerë prej 25.3 milionë eurosh përmes Qeverisë së Gjermanisë përkthazi Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) me 9 milionë euro, Qeverisë së Zvicrës me 8 milionë

euro, Qeverisë së Kosovës me 5 milionë euro dhe komunës së Pejës me 3.3 milionë euro përfshirë shpronësimin). Kapaciteti i impiantit është paraparë për 60 mijë banorë, me mundësi të zgjerimit deri në 98 mijë. Impianti është veçse në fazën testuese dhe pritet të inaugurohet në javët në vijim”, ka njoftuar Aliu.





# Teza e një psikologu: Ja pse njerëzimi e "dashuron" luftën

Lufta vazhdon ta prekë njerëzimin. Filozofia dhe teologjia kanë prodhuar shumë reflektime mbi këtë dukuri. Që në fillimet e mendimit perëndimor, Herakliti shkroi se "konflikti është 'babai' i të gjitha gjërave". Por është psikologjia ajo që na bën të kuptojmë origjinën e luftës.

Kështu Xhejms Hillman, një psikolog i shkollës Jungiane, që u nda nga jeta në vitin 2011, trajton gjerësisht këtë temë në librin e tij të famshëm "Dashuria e tmerrshme për luftën". Ky libër na ofron një panoramë të plotë mbi luftën dhe mekanizmat e zhvillimit të saj.

Hillman shkruan: "Në rast se nuk e kuptojmë këtë dashuri të fortë që ka njerëzimi për luftën, nuk do të jemi kurrë në gjendje që ta parandalojmë atë, apo të flasim në mënyrë të arsyeshme për paqen dhe çarmatimin. Nëse nuk e shtyjme imagjinatën tonë tek gjendja luftarake e shpirtit të njeriut, atëherë s'do të jemi në gjendje të kuptojmë forcën e saj tërheqëse.

Pra ne duhet të "shkojmë në luftë", dhe ky libër është menduar të jetë një thirrje nën armë për mendjen tonë. Dhe ne nuk do të shkojmë në luftë "në emër të paqes", siç

pretendon shpesh retorika hipokrite. Përkundrazi ne do të shkojmë në luftë në emër të luftës, ose siç e thekson Hillman për të kuptuar marrëzinë e dashurisë që kemi ndaj saj.

Ishte Xhiambatista Viko i pari që u interesua mbi arsyet themelore të ligjit, gjuhës, letërsisë: temat e përsëritura, strukturat dhe forcat e përvetshme, të kudogjendura, emocionale dhe të pashmangshme që veprojnë mbi çdo jetë njerëzore, në çdo shoqëri njerëzore, ndaj së cilës ne duhet të përkulemi.

Pra janë ato forcat që ne mund t'i etiketojmë si arketipale. Nëse gërmojmë pak më thellë do të zbulojmë se ka forca arketipale që nxjerrin në dritë temat mitike që përshkojnë kohërat dhe që janë të përvetshme. Dhe lufta është një forcë e tillë. Lufta është një temë e përvetshme e ekzistencës njerëzore, e cila merr kuptim nga mitet. Këtu qëndron edhe madhështia e kulturës greke: njohja e tragjedisë.

Ne e trajtojmë dukurinë e luftës, pa marrë parasysh mitet dhe Perënditë, a thua sikur këto të fundit të kenë vdekur dhe janë zhdukur. Megjithatë, tragjedinë dhe atë bashkim të çuditshëm midis



dashurisë dhe luftës, e gjejmë ende sot duke lexuar gazetën e këtyre ditëve mbi luftën në Ukrainë.

Një luftë e pakuptueshme dhe e paimagjinueshme, ngrihet në nivelin e një situatë mitike me Perëndi të gjalla dhe reale. Marsi dhe Afërdita janë gjithmonë mes nesh. Duhet reflektuar mbi pyetjen: A është vërtet anormale lufta? Mua më duket se nuk është kështu. Nëse shohim me vëmendje zhvillimet e pas Luftës së Dytë Botërore dhe ato pas konflikteve të mëdha që pasuan. Prandaj, po flasim për normalitetin e luftës duke supozuar një faktor tjetër: "pranueshmërinë"

e saj.

Luftërat nuk do të ndodhnin nëse nuk do të kishte njerëz të gatshëm që të kontribuonin për zhvillimin e tyre. Rekrutët, sklevërit, ushtarakët e karrierës: ka pasur gjithmonë njerëz të gatshëm për t'u përgjigjur thirrjes për t'u vendosur nën armë, për t'u regjistruar në ushtri, për të luftuar. Por pse lufta është normale? A është kështu sepse i ka trënjët tek natyra njerëzore, apo sepse është thelbësore për shoqëritë? A është në thelb ajo një shprehje e instinktit të agresionit dhe vetë-ruajtjes së qenieve njerëzore, apo është një zgjatim i sjelljes së tufës?

Sidoqoftë, në të dyja rastet, gjithçka i referohet nevojës për të pasur imazhin e një armiku. Lufta, shkruan Tomas Hobs, është një situatë në të cilën çdo njeri është armik i çdo njeriu tjetër. Pa armiq është e vështirë të bësh luftë.

Si një psikoanalist investigativ, Xhejms Hillman na thotë se lufta nuk është çnjerëzore, por njerëzore dhe i përket njerëzimit ashtu si racionaliteti dhe mendimi shkencor. Si mund të themi se lufta na bën të zbrisim në nivelin e kafshëve, nëse luftën e bëjnë vetëm njerëzit?

James Hillman ishte pacifist, ndaj thotë në librin e tij se lufta mund të ndalet vetëm duke e shndërruar në një mit kultin e tij. Nëpërmjet njohjes së miteve si standardizim i së paarsyeshmes, mund të gjendet tek identifikimi virtuti i tyre terapeutik. Kështu, duke depërtuar në sekretet e luftës, ne mund të zbulojmë mënyra të tjera për të kënaqur kërkesat e saj. Mënyra të tjera për të shkuar në luftë, pa e zhvilluar atë vërtet. / Giorgio Boratto, "Il Fatto Quotidiano" – Bota.al

## Zoti i rremë i Car Vladimirit

Nga Walter CLEMENS  
"Center for European Policy  
Analysis"

Koncepti "Zoti është me ne", ka qenë pjesë e ringjalljes së nacionalizmit rus të Vladimir Putinit, një pretendim që është në fakt sa një sakrilegjë aq edhe i pavërtetë. Administrata e Putinit ka zhvilluar një fushatë të zellshme dhe të përshpejtuar për të frenuar ndikimet e huaja.

Ajo ka mbyllur Memorial dhe organizata të tjera të drejtave të njeriut, me akuzën e të qenit "agjentë të dyshuar të të huajve". Ndërkohë Akademia Ruse e Shkencave dhe Duma, parlamenti rus po diskutojnë mënyrat për të kufizuar ndikimet që vijnë nga jashtë.

Disa zyrtarë propozojnë që çdo kontakt ndërmjet një shkencëtari të akademisë dhe një të huaji, duhet të autorizohet më parë nga drejtuesi i institutit. Sa herë që një shkencëtar rus takohet me ndonjë të huaj, duhet të jetë i pranishëm një person i tretë; dhe në fund drejtorisë së institucionit duhet t'i dorëzohet një raport mbi takimin.

Po ashtu, e gjithë korrespondenca me shkencëtarët e huaj, duhet të monitorohet nga drejtorja e institutit. Mundësitë që ofron sot bota dixhitale, po përmbushin parashikimet e George Orwell për një Ministri të plotfuqishme të së Vërtetës.

Në fundin e viteve 1980, presidenti

sovjetik Mikhail Gorbachev bëri thirrje që politikë-bërja të bazohej tek "vlerat universale", dhe jo tek ato të klasës apo komunizmit. Tani, gjërat po kthehen aty ku ishin, ndërsa regjimi i Putinit po përqafton një kod moral mbi ato që janë "bazat e politikës shtetërore për ruajtjen dhe forcimin e vlerave tradicionale shpirtërore dhe morale ruse".

Ai synon t'i kundërvihet ndikimeve perëndimore që mbjellin ide dhe vlera, të cilat konsiderohen si të huaja për popullin rus dhe shkatërruese për shoqërinë ruse. Këto vlera negative përfshijnë kultin e egoizmit, lejueshmërisë dhe imoralitetit, së bashku me çdo përpjekje për të mohuar idealet e patriotizmit, shërbimit ndaj Atdheut, riprodhimit dhe punës krijuese.

Po ashtu, Perëndimi akuzohet për poshtërimin e kontributit pozitiv të Rusisë në historinë dhe kulturën botërore. Në janar të këtij viti, zëvendës/redaktori i gazetës së fundit të madhe të pavarur në Rusi, Novaya Gazeta (tashmë e mbyllur) vuri në dukje se dokumenti, që do të firmoset në maj nga presidenti Putin, pretendon se "kollektivizmi" është i natyreshëm në popullin rus. Dokumenti nuk thotë asgjë për vlerat universale të përbashkëta që kanë shumë fe. Ai pretendon se vlerat ruse, burojnë nga më shumë se 1 mijë vjet traditë, kur vlerat fetare dhe shpirtërore të shumë popujve që jetojnë në Federatën Ruse, kanë konverguar në diçka të quajtur "Bota



Ruse" (Russkii mir).

Shumica e kishave të krishtera dhe feve të tjera kryesore në botë, pretendojnë se shpallin ideale universale dhe jo ato kombëtare. Megjithatë, ky tekst nuk flet kurrë për t'i shërbyer Perëndisë. Përkundrazi, ai e shenjtëron Atdheun.

Projekt-dekreti presidencial është për gatitur nga Ministria e Kulturës në përputhje me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Meqenëse ai parashikon ngritjen e një "organi koordinues ndër-institucional", pasardhësit e Big Brother (Vëllait të Madh) mund të kërkojnë ngritjen e një Ministrie të Vlerave (Komtsen), si dhe të një Ministrie të së Vërtetës.

Patriarkana e Moskës e fesë ortodokse ruse, është e përfshirë në mënyrë aktive në nismat patriotike të autoriteteve. Për shembull, mermi simbolin e militarizmit modern rus, Katedralen e Forcave të Armatosura, të ngritur në vitin 2018 në qarkun Odintsovsky, rreth 1 orë larg në

perëndim të Moskës.

Imazhet e engjëjve rinë pezull mbi armët e artilerisë. Imazhet fetare stolisin armët kallashnikov në stenda. Virgjëresha Mari shfaqet në një pozë që të kujton një poster sovjetik të "Luftës së Madhe Patriotike", dhe e gjithë godina është e veshur me një metal ngjyrë kaki, tamam si uniformat ushtarake.

Në frymën naziste "Gott mit uns", mozaikët e katedrales sugjerojnë se Zoti jo vetëm që bekoji Ushtrinë e Kuqe gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe veprimet ushtarake ruse në Hungari në vitin 1956, Çekosllovakia në vitin 1968, në Afganistan, por edhe aventurat më të fundit të presidentit Putin në Çeçeni, Gjeorgji, Krime dhe "luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar në Siri".

Një shërbëtor 28-vjeçar në katedrale, tha se "vetëm rusët janë në gjendje të sakrifkohen veten për të shpëtuar njerëzimin, ashtu siç bëri Jezusi". E

kombinuar me grupe të militarizuara të të rinjve si Ushtria Rinore (Yunarmia), katedralja dhe Parku Patriotik, i përgatisin rusët për luftërat heroike të së ardhmes.


Muajin e kaluar, Patriarku Ortodoks rus Kirill (i njohur dikur si një agjent i vjetër i KGB-së, dhe si kreu i një rrjeti të paligjshëm të kontrabandës së cigareve), bekoji me entuziazëm pushtimin e Putinit në Ukrainë, si një kryqëzatë kundër paganizmit perëndimor dhe homoseksualëve, deklaruar që shkaktoi kritikë të forta të disa klerikëve rusë por edhe liderëve të Kishës Ortodokse në Ukrainë dhe më gjerë.

Pikëpamja mbi "Russkii mir", e orkestruar në bashkëpunim me Patriarkun Kirill, është aleate me presidentin Putin në fushatën e tij për të shkatërruar shtetin dhe popullin ukrainas. Kisha ruse, siç sugjeron Alexander Motyl, duket se ka humbur shpirtin e saj.

Putini mund të shpresojë që i njëjti fat e pret popullin rus – siç bëri edhe protagonistin që ndërtonte anije kozmike në distopinë fantastiko-shkencore të shkrimtarit Yevgeny Zamyatin, të ndaluar nga censuruesit sovjetikë në vitin 1921. Derisa kirurgët ia hoqën shpirtin dhe imagjinatën, inxhinieri i raketave mundi të jetonte në botën e Bamirësit të Madh.

Shënim: Walter Clemens, bashkëpunëtor i Davis Center në Universitetin e Harvardit për Studimet Ruse dhe Euroaziatike.





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Llapi dhe Drita kualifikohen në finale të Kupës

Finalja e Kupës do të jetë në mes të Llapit dhe Dritës. Këto dy skuadra i kanë eliminuar Prishtinën, përkatësisht Ramiz Sadikun. Fituesi i kësaj gare e fiton të drejtën e pjesëmarrjes në arenën ndërkombëtare, Ligën e Evropës



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 13 PRILL** - Në finale të Kupës së Kosovës në futboll janë kualifikuar Llapi dhe Drita. Llapi është kualifikuar pas fitores me rezultat 2-0 ndaj Prishtinës në ndeshjen kthyesë të gjysmëfinale që është zhvilluar të mërkurën në stadiumin "Zahir Pajaziti". "Mendoj se Llapi është me shumë meritë në finale. Nuk jemi turistë, por kemi mundur ekipet më të forta të futbollit në Kosovë. Me plot meritë po shkojmë në finale. Kemi qenë shumë të kujdesshëm. Janë dy lloje supash, e knusit dhe e pulës. Prishtina për mua ka qenë si një supë e pulës. Sot shënuam dy

gola. E merituar fitoren", ka thënë Tahir Batatina, trajner i Llapit.

Në pjesën e parë, Prishtina kaloi në epërsi, por goli u anulua pasi Otto John ishte në pozitë jashtë loje. Në minutën e 58 Llapit shënoi golin e epërsisë nëpërmjet Bianor Neto. Ramadani pati mundësinë ta dyfishojë rezultatin, por gjuajtjen e tij nga penalltia e ndali portieri Haxho.

Njëmbëdhjetë minuta para fundit Rivera shënoi golin e dytë dhe të kualifikimit. "Ka qenë ndeshje, por më së paku ka pasur futboll. Është marre për futbollin e Kosovës. E kemi parë çka na pret gjatë përgatitjeve të djeshme, por jo bash kështu. Me vazhdimin e lojës na ka rënë loja sepse çdo

kontakt i futbollistëve ka qenë faull. Besoj shumë në lojtarët e mi. Ata janë trima dhe do të dalin lehtë prej kësaj situatë", ka thënë Abdulah Ibraković, trajner i Prishtinës.

Ndeshjen e parë në "Fadil Vokrri" Prishtina e kishte fituar me rezultat 2-1. Në ndeshjen tjetër Ramiz Sadiku dhe Drita luajtën baras 2-2. Vendasit shënuan të parët në minutën e 56, kur Sadiku realizoi nga penalltia. Musa shtoi shifrat në 2-0, kurse Drita nuk u dorëzua dhe nuk lejoi befasi, duke shënuar dy gola. Realizues ishin Tahiri dhe Kryeziu në minutat e fundit të ndeshjes. Drita kualifikohet për arsye se ndeshjen e parë e ka fituar me rezultat 3-0.

## SHKURT

### Frashëri rikthehet në stërvitje

Skuadra lidere e BKT Superligës, Ballkani, ka njoftuar se portieri Stivi Frashëri është rikthyer në stërvitje. "Rikthehet në stërvitje Stivi Frashëri", thuhet në postimin e klubit nga Suhareka. Siç dihet, portieri shqiptar ishte sulmuar fizikisht në derbin Gjilani - Ballkani, me ç'rast kishte përfunduar pa ndjenja në spital. Tifozët ishin futur në fushë në minutat shtesë për ta festuar golin e barazimit të Gjilanit, por disa tifozë e sulmuan fizikisht portierin mysafir, madje njëri prej tyre e goditi me shqelm në kokë. Ndeshja ishte ndërprerë dhe Ballkani kishte fituar në tavolinë 3-0 dhe Gjilani ishte dënuar me tri ndeshje pa praninë e shikuesve në stadium.

### Peja organizatore e 'Final Four' të Ligës Unike

KB Peja do të jetë nikoqire e "Final Four" të Ligës Unike në basketboll. Federata e Basketbollit e Kosovës ka bërë me dije se qyteti i Pejës, KB Peja ka fituar të drejtën e organizimit të "Final Four" në kuadër të Ligës Unike.

FBK-ja ka paralajmëruar një konferencë për medie sot (e enjte), me fillim nga ora 13:00. Aty do të nënshkruhet marrëveshja ndërmjet Ligës Unike dhe KB Peja për organizimin e "Final Four". Peja, Prizreni 16, Golden Eagle Ylli dhe Teuta janë katër skuadrat gjysmëfinaliste të Ligës Unike.

### Futbollistja Kosovare Asllani kualifikon Suedinë në Botëror

Futbollistja Kosovare Asllani ia ka siguruar kualifikimin Suedisë për në Kampionatin Botëror të Australisë dhe Zelandës së Re. Suedia është bërë Kombëtarja e parë që u kualifikua në Kampionatin Botëror që do të mbahet në vitin 2023. Asllani shënoi golin e mjaftueshëm mbrëmë në barazimin 1:1 në shtëpi ndaj Irlandës. Suedia kishte nevojë vetëm për një pikë për të shkuar në Botëror dhe atë e arriti ndaj irlandezeve. Asllani shënoi në minutën e 79 për t'ia siguruar kualifikimin Suedisë. Suedia është në Grupin A me 19 pikë pas shtatë ndeshjeve të zhvilluara, kurse Irlanda e treta me tetë pikë. Pas ndeshjes ka reaguar vetë futbollistja nëpërmjet një postimi në "Facebook". "U kualifikuam në Botëror. Shihemi në Australi/Zelandë të Re 2023", ka shkruar Asllani. Në të kaluarën 32-vjeçarja ka qenë pjesë e Paris Saint-Germainit, Manchester Cityt, kurse tani është pjesë e Real Madridit.

## Xhaka: Nuk largohem nga Arsenali pa arritur diçka të veçantë

**LONDËR, 13 PRILL** - Mesfushori shqiptar Granit Xhaka ka insistuar se dëshiron të arrijë diçka të veçantë me Arsenalin. Spekulumet kanë qenë të shumta rreth të ardhmes së Xhakës pavarësisht se zvicëri nënshkroi një zgjatje të kontratës verë e kaluar. Roma pritet ta ringjallë interesin për Xhakën këtë verë, por 29-vjeçari ka plane të tjera, duke përfshirë

afrimin me tifozët e Arsenalit. "Dua të kem një marrëdhënie më të mirë me njerëzit jashtë, me tifozët, për të qenë më afër me ta. Nuk i takojmë asnjëherë, nuk bëjmë asnjëherë bisedë me ta", ka thënë Xhaka. "Ata po na shohin në fushë vetëm për 90 minuta dhe lamtumirë. Ata nuk e dinë se si kemi stërvitur më parë, nuk e dinë se si ndihesh, nuk e dinë nëse ke probleme në

familjen tënde, nuk dinë shumë pika. Pas sezonit kam ende dy vjet kontratë këtu. Do të jap gjithçka derisa të jem në këtë klub futbollit. Këtë e them gjithmonë. Unë nuk kam nënshkruar një kontratë të re, por e shijoj kohën time dhe kaq. Dua të arrij diçka me këtë klub, diçka të veçantë. Dhe para kësaj, nuk largohem", ka deklaruar Xhaka.





## Ancelotti: Ishte e vështirë, por Reali nuk dorëzohet kurrë

MADRID, 13 PRILL - Real Madridi u kualifikua në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve ani pse e humbi ndeshjen e dytë me rezultat 2-3. "Mbretërit" janë kualifikuar me rezultat të përgjithshëm 5-4. Trajneri Carlo Ancelotti ka

thënë se loja ishte e vështirë, por Reali nuk dorëzohet asnjëherë. "E dinim se do të ishte e vështirë, por jo aq shumë sa doli të ishte. Kemi shkuar në 0-2 pa meritë, pasi mendoj se në pjesën e parë kemi luajtur mirë, duke mos rrezikuar

shumë. Në një moment u gjendëm në 0-2 dhe më pas kualifikimi ishte në dyshim. Ishte sakrificë nga ana e të gjithëve. Shpirti i Realit është ky: nuk dorëzohemi kurrë dhe për këtë e morëm këtë shpërblim të madh, që është gjysmëfinalja",

ka thënë Ancelotti. "Kur ndeshja u bë e barabartë, ambienti na ka ndihmuar. Goli për 1-3 ka qenë një goditje psikologjike përpara, më pas e kemi ndërtuar fitoren, respektivisht kualifikimin. Është e vërtetë që Reali është mësuar në gjysmëfinale të Ligës së



Kampionëve. Jemi mjaft krenarë me këtë arritje", ka shtuar Ancelotti.

## Xavi: E kemi detyrim kualifikimin, kërkojmë mbështetjen e tifozëve

BARCELONË, 13 PRILL - Barcelona do të përballlet me Eintrachtin e Frankfurtit për ta zhvilluar ndeshjen e kthimit të fazës çerekfinale të Ligës së Evropës, takim që do të luhet në "Camp Nou". Një sfidë shumë e rëndësishme për katalanasit të cilët do të kërkojnë kualifikimin në gjysmëfinale pas barazimit 1-1 të arritur në duelin e parë në Gjermani. Në konferencën për shtyp trajneri Xavi Hernandez foli për përballjen me gjermanët, ku spanjollit shprehet se skuadra e tij e ka detyrim kualifikimin përballë tifozëve të tyre. "Ne kemi detyrimin të fitojmë. Duhet të jemi të shkëlqyer në çdo gjë që bëjmë. Është klubi më i vështirë në botë, më kërkuar. Të fitosh duke luajtur mirë është shumë e vështirë. Për ta është ndeshja më e rëndësishme në



histori. Ne duhet të përshtatem me intensitetin dhe dëshirën e tyre. Nesër tifozët duhet të jenë me ne dhe të tregojnë se çfarë kanë bërë që kur kam qenë trajner. Unë jam i sigurt se do të jenë aty për të na mbështetur", ka deklaruar Xavi.

Për atmosferën në "Camp Nou", Xavi ka deklaruar: "Të luash ndeshjen e dytë në shtëpi është një nga çelësat e ndeshjes. Tifozët tanë nuk do të na lënë keq. Ne do të përpiqemi t'i bëjmë ata të ndihen krenarë".

## Mercedesi kundër Hamiltonit: Në Australi, më të fortë nga sa menduam

LONDËR, 13 PRILL - Lewis Hamiltoni, pas garës së Australisë, u shpreh dy ditë më parë se makina Mercedes nuk ka bërë hapa përpara. Gjithsesi, krejt ndryshe mendon drejtori sportiv i makinës gjermane, Toto Wolff. Sipas tij, skuadra kampione në Formula 1 largohet nga Melbourne më e fortë se kur vajti. "Largohemi nga Australia në një situatë më të mirë krahasuar me atë kur erdhëm. Mësuam shumë dhe mblodhëm



mjaft të dhëna si dhe një vend të tretë e të katërt me dy pilotët tanë. Natyrisht nuk kemi ende ritmin

për ta sfiduar Ferrarin apo Red Bullin, por tani e dimë se ku duhet të punojmë", ka thënë Wolff. "Ajo që më gëzon është mentaliteti që ka skuadra. Jo vetëm ne që udhëtojmë e marrim pjesë në gara, por edhe ata që janë në Angli e Gjermani po punojnë për ta ndryshuar ritmin. U përpoqëm të duelojmë me më të mirët me këtë makinë që kemi dhe kjo është inkurajuese", ka shtuar shefi i Mercedesit.

## Ish-numri 1 në botë tërhiqet nga tenisi për të tretën herë

Tenistja belge Kim Clijsters, ish-numri 1 në botë për femra dhe fituese e 4 grand slameve në karrierë, ka deklaruar tërheqjen e saj nga sporti për të tretën herë. Fillimisht ajo u tërhoq në vitin 2007, por u rikthye pas dy vjetësh. Për herë të dytë u tërhoq në vitin 2012 dhe u rikthye pas 7 vjetësh. Pas rikthimit në vitin 2019 ajo luajti vetëm 5 ndeshje si pasojë e pandemisë. Tashmë 38 vjeçe dhe



me 3 fëmijë, ajo duket se ka vendosur përfundimisht të mos

luajë më tenis. Sfida e saj e fundit zyrtare daton në tetorin e vitit të kaluar, kur u eliminua që në raundin e parë të Indian Wells. "Dua të ndaj me ju lajmin se kam vendosur të mos luaj më asnjë ndeshje apo turne zyrtar. Mezi po pres të shoh se çfarë aventure të re ka rezervuar jeta ime. Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen!", u shpreh tenistja belge, fituese e 41 turneve në karrierën e saj.

### SHKURT

#### Tuchel: Gjyqtarin e gjeta atje duke qeshur me Ancelottin

Trajneri i Chelseat, Thomas Tuchel, nuk ishte aspak i lumtur në fund të ndeshjes së kthimit me Realin e Madridit, në "Santiago Bernabeu". Ai është shprehur i zhgënjyer me gjyqtarin e ndeshjes. "I thashë se jam shumë i zhgënjyer që nuk shkoj ta shihje vetë rastin e golit të anuluar të Alonsos. Kur mbaroi ndeshja, pashë gjyqtarin duke qeshur me zë të lartë me Ancelottin dhe m'u duk shumë keq. Shkova t'i shtrëngoja dorën pas një disfate të rëndë dhe e gjeta atje duke qeshur me trajnerin rival, me Ancelottin, i cili është një zotëri. Nuk mendoj se ishte momenti i duhur për ta bërë këtë", ka thënë Ancelotti. "Shënua katër gola në dy ndeshje dhe kemi pasur më shumë raste, por ishim të pafat. Jemi të zhgënjyer, sepse bëmë dy gabime. Momenti më i rëndësishëm i lojës ishte gabimi ynë. Në ndeshje si kjo, duhet pak fat dhe nuk e patëm", ka shtuar Ancelotti.

#### Nagelsmann: Eliminim i hidhur, e vështirë për të çarë një mbrojtje të tillë

Julian Nagelsmann e kishte menduar ndryshe ndeshjen kundër Villarrealit. Trajneri i Bayern Munchenit nuk e fshehu zhgënjimin për këtë eliminim të skuadrës së tij ndaj spanjollëve duke thënë pas ndeshjes se ndeshja e parë ndikoi jo pak në rezultat përfundimtar. "Ndeshja e parë ishte çelësi. Ne bëmë një ndeshje shumë të mirë, një nga lojërë tona më të bukura. Duhet të shënonim 2-0 në pjesën e dytë për të mos e lënë ndeshjen të hapur. Eliminimi në këtë mënyrë është shumë i hidhur. Nuk kishim shumë hapësirë dhe gjithmonë ekzistonte rreziku i një kundërsulmi. Megjithatë, është e vështirë të krijosh shumë raste kundër një skuadre që luan kaq të thellë në zonën e saj", ka thënë Nagelsmann.

#### Ibra mungon dhjetë ditë

Zlatan Ibrahimović bën një tjetër ndalesë, në një sezon të vështirë. Pasi humbi sfidën kundër Torinos, sulmuesi suedez ka marrë lajmin negativ që do të qëndrojë jashtë fushave të lojës të paktën për 10 ditë për një mbingarkesë në gju. Kjo është një tjetër goditje për Milanin dhe një mungesë e madhe në këtë fazë vendimtare të sezonit. Ibrahimović nuk do të luajë në dy ndeshjet e Serisë A kundër Genoas dhe Lazios, por edhe sfidën e kthimit në Kupën e Italisë kundër Interit. Nëse nuk do të ketë surpriza gjatë rikuperimit, 40-vjeçari do të jetë i gatshëm për skuadrën e Piolit për duelin kundër Fiorentinës në "San Siro". Gjithsesi nga infermeria nuk ka vetëm lajme negative, pasi Ante Rebic dhe Castillejo janë rikthyer në stërvitje me grupin, duke kaluar problemet muskulore. Romagnoli vijon stërvitjet e diferencuara në palestër, ndërkohë që Bennacer është stërvitur veçmas në fushë me topin.

## Brooklyni dhe Minnesota kalojnë në 'play-off'

Kanë nisur ndeshjet e "play-in" në NBA, ku spektakli nuk ka munguar. Brooklyn Nets dhe Minnesota fituan sfidat përkatëse dhe siguruan kualifikimin në çerekfinale të "play-off"-it. Ndeshje shtesë, që

e bëjnë edhe më interesant sezonin. Brooklyn Nets, që luante në fushën e vet, mundi 115-108 Cleveland Cavaliers, një takim ku vendasit dominuan që nga fillimi deri në fund sa që në fund të periodës

së parë shkuan deri në 20 pikë avantazh. Për miqtë u dallua Garlandi me 34 pikë, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Po 34 pikë realizoi edhe Irvingu për Netsin, mbështetur edhe nga Duranti

me 25 pikë. Në ndeshjen tjetër, skuadra e Minnesotas mposhti 109-104 Los Angeles Clippers, edhe kjo një përballje me rivalitet. Edwardsi me 30 pikë e Russell me 29 pikë bënë diferencën për Minnesotan.

Ndërsa 34 pikët e veteranit Paul George për Clippersin mbetën për statistikë. Brooklyn në çerekfinale do të luajë ndaj Boston Celticsit, ndërsa Minnesota ndaj Memphis Grizzliesit.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "AGR" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811902015 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AGR" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811902015 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "AGR" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811902015 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "BE Betoni" Sh.p.k Skenderaj, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Polac, Skenderaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.05.2022 në ora 10:00 në restorantin "Freskija" në Skenderaj, rruga R 102, i cili ndodhet në dalje të qytetit afër rrethrotullimit të Magjistrates Skenderaj -Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania "BE Betoni" Sh.p.k Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës. Debat publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Polac, Skenderaj.

Debat publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJkUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "BE Betoni" Sh.p.k Skenderaj për bazën e prodhimit të betonit në Polac, Skenderaj.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

# Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:  
**044-514-373 dhe 044-199-707.**

**RESTAURANT**

# SWISS

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

▶ Samir Krasniqi shpall të pavlefshme 1 dëftesë shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Egzona Ademaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

▶ Fatmire Gerbani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "Matilo Goreci" Prizren.

▶ Sadbere Mucaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.

▶ Halil Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

Edonisaj Rramanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "Naim Frasheri" Kobaje.

▶ "3B Kosova" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330349250.

▶ Kastriot Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. "Shtjefën Kurti" Novosell e epërme nga kl. I-V dhe VI-IX.

▶ Rilvin Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Zamira Xharra nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Klementina Lilaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.F.U. "Isa Boletini" Kk Gjakovë.

▶ Bashkim Demolli shpall të humbur letërnjoftimin, vendlindja Glogovicë KK. Prishtinë.

▶ NPNT "XHAFI" me numer biznesit 810358095 shpalle te humbur arken fiskale me numer serik GK 52200882

▶ Isufi zeneli shpalle te pavlefshme diplomen e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ Fitim Hajdini shpalle te pavlefshme certifikaten e leshuar nga qendra per aftesim profesional - Mitrovice kursi Ndertimtari nr i certifikates 346/2011

▶ Bujar Tahiri shpalle te pavlefshme deftesat dhe diplomen e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ Selvije Rushiti shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore "Azem Bejta" Prekaz

▶ Burim D Bajraktari B.I shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb : 810569519

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

